

Shpërthimi i bombës në Ambasadën Sovjetike dhe ekzekutimi pa gjyq i Sabiha Kasimati dhe 21 intelektualëve të tjerë

Sabiha Kasimati

MINISTRIJA P. MBRENDESHME
Drejtorija e Sigurimit Shtetit

Dega
Seksioni P. Mbrodëshme

Nr. i Regj. _____

DOSJA E HETUESIS

Për: 1- Letër dhe

Akuzat: 2- Kërkesa për
3- Të tjerë

Në bazë të nenit: 1- Neni 101 të Kushtetutit

Të ligjit: 1- Dekreti i Kuvendit
2- Dekreti i Kuvendit
3- Dekreti i Kuvendit
4- Dekreti i Kuvendit

Data e fillimit: 1- 10.10.1951

Data e mbarimit: 1- 10.10.1951

ARSHIVUAR:
Nr. 254/A Data 10.10.1951
Arsyeja e Arshivimit 1- 10.10.1951

TEPER SEKRET Model 7

1687

SEKSIONI

Figura historike

PERIUDHA

1937 - 1991


Pas shpërthimit të një sasive të vogël dinamiti në oborrin e Ambasadës Sovjetike më 19 shkurt, regjimi komunist e përdori këtë ngjarje si pretekst për të sulmuar elitën intelektuale. Sabiha Kasimati së bashku me 21 intelektualë të tjerë u arrestuan dhe akuzuan pa prova konkrete si "armiq të popullit" dhe "terroristë". Pa mundësi për mbrojtje dhe pa një gjykim të rregullt, ata u pushkatuan pranë Urës së Beshirit më 26 shkurt 1951, ndërkohë që vendimi për ekzekutim u mor më 27 shkurt 1951, një ditë pas vdekjes së tyre. Pas rënies së regjimit komunist në vitin 1991, familjarët e viktimeve kërkuan zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin e vendit të ekzekutimit. Plenumi i Gjykatës së Lartë i shpalli të pafajshëm të dënuarit, duke e cilësuar vendimin nr. 64, datë 27.02.1951 të Gjykatës së Lartë Ushtarake si të kundërligjshëm dhe të pambështetur në prova konkrete. Pas hetimeve, në vitin 1993 u identifikua vendi i ekzekutimit dhe eshtrat e viktimeve u varrosën me nderime në varrezat e Dëshmorëve të Kombit.

Sabiha Kasimati në dosjet e Sigurimit të Shtetit

*]:pointer-events-auto [content-visibility:auto] supports-[content-visibility:auto]:[contain-intrinsic-size:auto_100lvh] scroll-mt-[calc(var(--header-height)+min(200px,max(70px,20svh)))]" dir="auto" tabindex="-1" data-turn-id="request-WEB:611fb96b-60e8-4437-aba6-43ee363d8cec-0" data-testid="conversation-turn-2" data-scroll-anchor="true" data-turn="assistant"> Dosja e hetuesisë nr. 1687 në Arkivin e Sigurimit të Shtetit ,përbëhet nga 246 faqe, prej të cilave janë përzgjedhur në këtë postim vetëm 14 prej tyre. Dosja dokumenton një nga episodet më të errëta të historisë së diktaturës komuniste në Shqipëri: arrestimet dhe ekzekutimet e kryera në periudhën 20–23 shkurt 1951. Ngjarja lidhet drejtpërdrejt me hedhjen e bombës sovjetike në Ambasadën e Bashkimit Sovjetik në Tiranë, e cila u përdor nga regjimi komunist si pretekst për nisjen e një vale të menjëhershme arrestimesh, hetimesh të paligjshme dhe ekzekutimesh pa gjyq. Arrestimet u kryen pa urdhërarrest të prokurorit dhe pa vendim gjykate, duke i bërë ato tërësisht të paligjshme. Vetëm pas ekzekutimit të të ndaluarve u plotësuan formalisht urdhërarrestimet dhe procesverbalet e të ashtuquajturit “gjykim”, në përpjekje për të justifikuar një vendim të marrë paraprakisht. Sipas Vendimit nr. 64, datë 27.02.1951 të Gjykatës së Lartë Ushtarake, grupi i arrestuar u akuzua si armik i pushtetit popullor, me pretendimin se përbëhej nga individë të shtresave të larta shoqërore, ish-funksionarë dhe persona me privilegje të humbura, të cilët gjoja synonin përmbysjen me forcë të regjimit. Akuzat përfshinin propagandë kundër pushtetit dhe veprimtari armiqësore, çka shërbeu si bazë për dënimin kapital dhe ekzekutimin e tyre. Dosja përmban gjithashtu kërkesën e familjarëve të viktimave, drejtuar institucioneve më të larta shtetërore më 24.06.1991, ku kërkohet zbardhja e plotë e rrethanave të pushkatimeve, përcaktimi i numrit të saktë të viktimave dhe identifikimi i vendndodhjes së varreve apo gropës së përbashkët ku u hodhën trupat e tyre. Në këtë kërkesë theksohet se, edhe pas më shumë se 40 vitesh, e vërteta vazhonte të mbetej e fshehur. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, me Vendimin nr. 64, datë 10.08.1991, Pleniumi i Gjykatës së Lartë vendosi prishjen e vendimit të vitit 1951, duke e konsideruar atë një akt të rëndë shkeljeje të ligjit dhe të drejtave themelore të njeriut.


Letra e familjarëve të viktimave të pushkatuar pa gjyq

MEDIA FAQE #1



Letra e familjarëve të viktimave të pushkatuar pa gjyq

MEDIA FAQE #2



INFORMACION

Letra e familjarëve të viktimave të pushkatuar pa gjyq


VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT	1991
DOSJA	1687
TIPOLOGJIA E DOSJES	Hetuesie
VITET EKSTREME	1937-1991
NIVELI I KLASIFIKIMIT	Tepër sekret

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Lista emërore e personave të pushkatuar

MEDIA FAQE #1



Lista emërore e personave të pushkatuar

INFORMACION

Lista emërore e personave të pushkatuar

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

basë të ligjit të ri për aktet terroriste, pa përmendur cili është ai akt dhe as kohën e daljes së tij. Në këtë rast duhet të jetë fjala për dekretin Nr.123, datë 26.2.1951, që është miratuar po ditën e shqyrtimit të çështjes në gjykatë. Duke qenë çështja kështu, edhe në bazë të atij dekreti, shqyrtimi i çështjes në gjykatë, ka qenë i kundërligjshëm. Kjo për arsye se të gjitha veprimet hetimore janë kryer jo në bazë të ligjit, mbasi ato janë kryer pa dalë ligji i ri. Pra veprimet hetimore e gjyqësore i kanë paraprirë ligjit.

Dhe të gjitha këto veprime të kundërligjshme, mbyllën me një vendim po të kundërligjshëm. Në vendim gjyqësor megjithëse akuzohen për organizim e pjesëmarrje në organizatë terroriste, nuk sillët asnjë provë dhe nuk bëhet asnjë analizë. Përkundrazi, edhe nga shpjegimet e të gjykuarve nuk del asnjë e dhënë që ata jo më të jenë organizuar apo biseduar midis tyre për organizatën terroriste, por as dhe të kenë njohje.

Dhe së fundi vendimi gjyqësor, nuk nënshkruhet rregullisht nga gjithë trupi gjyqësor, mbasi mungon firma e një anëtar.

Të mara në tërësi këto shkelje të ligjit si dhe mungesa e plotë e një hetimi objektiv, e bëjnë vendimin e gjykatës të kundërligjshëm.

PRANDAJ,

Në bazë të neneve 179 e vijues të K P Penale,

K Ë R K O J :

Prishjen e vendimit penal Nr.64, datë 27.2.1951, të Gjykatës së Lartë Ushtarake dhe pashimi i çështjes.

K R Y E T A R I

/ Kleanth Koçi /



Kryetari i Gjykatës së Lartë Kleanth Koçi, i drejtohet Plenumit të Gjykatës së Lartë për prishjen e Vendimit

INFORMACION


Kryetari i Gjykatës së Lartë Kleanth Koçi, i drejtohet Plenumit të Gjykatës së Lartë për prishjen e Vendimit

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.


Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

MEDIA FAQE #1



Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

MEDIA FAQE #2



- 3 -

14. MYFTAR JEGENI, lindur në Dibër të Madhe, banues në Tiranë, nëpunës, i arrestuar më 20.2.1951.

15. QEMAL KACARUHO, i biri i Nuriut, i dtl.1902, lindur në Gjirokastrë e banues në Tiranë, shtresë e pasur, nëpunës, i arrestuar më 20.2.1951.

16. MANUSH PESHKOPJA, i biri i Tasimit dhe i Marijes, lindur në Vlorë e banues në Tiranë, shtresë e pasur, i dënuar më 1945 si kriminel lufte, nëpunës, i arrestuar më 20.2.1951.

17. ANDON DEHLYSA, i biri i Stefanit dhe i Lileës, i dtl. 1904, lindur në Prizren (Kosovë) e banues në Tiranë, teknik nërtimi, shtresë e pasur, i arrestuar më 20.2.1951.

18. REIS SENO, i biri i Xhevdetit dhe i Zakijes, i dtl. 1896, lindur në Gjirokastrë e banues në Tiranë, tregtar, shtresë e pasur, i arrestuar më 23.2.1951.

19. GJON TEMALI, i biri i Markut dhe i Marijes, i dtl. 1904, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, farmacist, i arrestuar më 20.2.1951.

20. PJETERIN GURASIU, i biri i Filipit dhe i Lileës, i dtl. 1902, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, nëpunës, shtresë e pasur, i arrestuar më 22.2.1951.

21. MENIMEN SHKUPI, i biri i Aliut dhe i Elifës, i dtl. 1892, lindur në Shkup e banues në Tiranë, kaloriferist, i arrestuar më 20.2.1951.

22. SABIHAN KASIMATI, e bija e Abdurramanit dhe e Zerasës, e dtl.1916, lindur në Turqi e banuese në Tiranë, nëpunëse, e arrestuar më 20.2.1951.

T E R M I N I M I :

Për faze kundër popullit dhe shtetit, parashikuar nga nenet 2 dhe 3 (pikat 7,8 dhe 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946.

Me vendimin Nr.64, datë 27.2.1951, të Gjykatës në Lartë Ushtrake Tiranë, është vendosur deklarimi fajtorë i të gjithë të gjykuarve për krimin e kryer kundër popullit dhe shtetit dhe në bashkë të neneve 2 dhe 3 (7,8 dhe 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946, të gjithë janë dënuar me vdekje.

./..

- 4 -

Kundër vendimit të mësipërm ka bërë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kryetari i Gjykatës në Lartë, duke kërkuar prishjen e tij dhe pushimin e çështjes duke i deklaruar ata të pafajshëm për këto shkeqe :

- Vendimi i gjykatës nuk mbështetet në asnjë provë dhe është i kundërligjshëm.
- Nga materialet e kësaj dosjeje, rezulton se nuk janë zbatuar rregullat procedurale kryesore, si vendimi për fillim të çështjes penale, nuk u është komunikuar ndonjë akuzë, nuk janë pyetur dhe nuk kanë dhënë asnjë shpjegim në hetuesi (me përjashtim të të gjykuarit Gjon Temali), nuk u është komunikuar kopja e akt-akuzës etj.
- Edhe në seancë gjyqësore, të gjykuarit janë pyetur fare shkurt, nuk janë ballafaquar dhe nuk është administruar asnjë provë tjetër.
- Çështja është shqyrtuar në gjykatë më 26.2.1951, pra ditën që ka dalë Dekreti i Ri Nr.1223, datë 26.2.1951, "mbi hetimin e gjykimin e veprave terroriste". Duke qenë kështu, edhe në bashkë të atij dekreti, shqyrtimi i çështjes në gjykatë ka qenë i kundërligjshëm për arsye se të gjitha veprimet hetimore janë kryer pa dalë ligji i ri.
- Vendimi përfundimtar i gjykatës nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjyqësor, mbase mungon firma e njërit prej anëtarëve.

PLENUMI I GJYKATËS SË LARTË,

pesi dëgjoi relacionin e anëtarit Agim Shkupi, zëvendësprokurorin e Përgjithshëm, Spiro Peçi, që shfaqti mendimin për pranimin e kërkesës si dhe pesi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V E N D I M I :

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e drejtë dhe duhet pranuar në tërësi.

./..

- 5 -

Me akt-akuzën datë 25.2.1951, të prokurorit ushtarak të gjykuarit : Tefik Shehu, Hekuran Troka, Lluka Rashkoviç, Haki Kodra, Pandeli Nova, Thoma Katundi, Fadil Disedari, Ali Qorallia, Jomë Kaceli, Gafur Jegeni, Petro Ekonomi, Zyhdë Herri, Niko Lero, Myftar Jegeni, Qemal Kacaraho, Mamush Peshkëpia, Andon Delhysa, Reis Selfo, Gjon Temali, Fjetrin Guraziu, Mehmet Shkupi dhe Sahiha Kasimati, janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Lartë Ushtarake Tiranë ndërmjet akuzës për fajë kundër popullit e shtetit, të parashikuara nga nenet 2 dhe 3 (pikat 7, 8 dhe 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946.

Megjithatë bëhet fjalë për akuzë shumë të rënda, dosja hetimore nuk përmban asnjë provë. Jo vetëm që nuk janë pyetur të gjykuarit (me përjashtim të Gjon Temalit), por nuk është pyetur asnjë dëshmitar apo nuk është administruar ndonjë provë shkretëre që të fajsoante të gjykuarit. Po ashtu, nuk ka vendim mbi fillimin e çështjes penale, vendim mbi marrjen e të pëndeher dhe komunikim të akuzës dhe përfundimisht as akt-akuzë nuk u është dorëzuar apo bërë e njohur të pëndeherve. Të gjitha këto përbëjnë shkelje të rënda të ligjit.

Gjykata, çështjen e ka shqyrtuar në seancë gjyqësore më 26.2.1951, pa pjesëmarrje të prokurorit dhe të avokatëve mbrojtës. Sikundër rezultoi nga procesverbali, në seancë gjyqësore janë dërguar vetëm të pëndeherit të cilët janë pyetur fare shkurt. Megjithatë ata janë akuzuar për organizim e pjesëmarrje në një organizatë terroriste, gjykata nuk është ndalur fare për vërtetimin e kësaj akuzë. Përkundrazi, nga shpjegimet që kanë dhënë të gjykuarit, ka dalë se ata jo vetëm që nuk kanë krijuar apo organizuar ndonjë organizatë terroriste por për më tepër ata as që kanë qenë njohur apo të kenë patur ndonjë lidhje midis tyre. Në mungesë të hetimeve paraprake (hetuesisë), gjykata i binte ari detyrë që të paktën çështjen ta hetonte në mënyrë të plotë në seancë gjyqësore. Por dhe këto detyrë gjykata nuk e ka realizuar. Kështu jo vetëm që nuk është administruar ndonjë provë tjetër, ai pretje dëshmitarësh, administrim provash të tjera të nevojshme, por as që janë bërë ballafaqime midis të gjykuarve. Pra mungesa e hetimit ka vashduar dhe në gjykim. Dhe në fakt, edhe gjykata nuk ka patur se çfarë të hetonte, mbasi nuk ka patur asnjë fakt që të gjykuarit të kishin kryer ndonjë aktivitet armiqësor kundër popullit dhe shtetit.

/..

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

- 6 -

Nga ana tjetër, në vendimin e gjykatës thuhet se çështja është shqyrtuar në bazë të rregullave që parashikon Ligji i Ri "Mbi hetimin e gjykimin e veprave terroriste", pa përmendur se cili është ky ligj. Në këtë rast duhet të jetë fjala për Dekretin Nr.1223, datë 26.2.1951, pra që është nxjerrë pa ditën e shqyrtimit të çështjes në gjykatë.

Duke qenë kështu, edhe gjykata nuk e ka patur parasysh në shqyrtimin e çështjes, mbasi po të di të që ka dalë ai dekret është shvilluar dhe seanca gjyqësore.

Dhe së fundi procesverbali i seancës gjyqësore jo vetëm që nuk është nënshkruar nga kryetari i seancës dhe sekretari, por as është mbyllur. Po ashtu dhe në vendimin përfundimtar të gjykatës, mungon firma e një anëtarit të trupit gjyqësor.

Të mara në tërësi këto shkelje të ligjit si dhe mungesa e plotë e fakteve dhe e provave, e bëjnë vendimin të kundërligjshëm. Për rrjedhojë, përderisa nuk vërtetohet që të gjykuarit të kenë kryer veprat penale për të cilën janë deklaruar fajtorë dhe dënuar, çështja penale në ngarkim të tyre duhet të pushohet dhe ata të deklarohen të pafajshëm.

PËR KËTO ARSYE .

Flemoni i Gjykatës së Lartë, në bazë të neneve 182/2 dhe 185/3 të K P Penale.


V E N D O S I :

Prishjen e vendimit Nr.64, datë 27.2.1951, të Gjykatës së Lartë Ushtarake Tiranë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të gjykuarve : Tefik Shehu, Hekuran Troka, Lluka Rashkoviç, Haki Kodra, Pandeli Nova, Thoma Katundi, Fadil Disedari, Ali Qorallia, Jomë Kaceli, Gafur Jegeni, Petro Ekonomi, Zyhdë Herri, Niko Lero, Myftar Jegeni, Qemal Kacaraho, Mamush Peshkëpia, Andon Delhysa, Reis Selfo, Gjon Temali, Fjetrin Guraziu, Mehmet Shkupi dhe Sahiha Kasimati.

/..

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

MEDIA FAQE #7



Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

INFORMACION


Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Raport Informativ i Sektorit të Bandave datë 19.07.1951

MEDIA FAQE #1



Raport Informativ i Sektorit të Bandave datë 19.07.1951

INFORMACION

Raport Informativ i Sektorit të Bandave datë 19.07.1951

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript për këtë media.

Përkujtime të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet të ish-Sigurimit të Shtetit në nderim të të ekzekutuarve në masakrën e 26 Shkurtit.

MEDIA FAQE #1



Përkujtime të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet të ish-Sigurimit të Shtetit në nderim të të ekzekutuarve në masakrën e 26 Shkurtit.

INFORMACION

Përkujtime të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet të ish-Sigurimit të Shtetit në nderim të të ekzekutuarve në masakrën e 26 Shkurtit.

Autoret: AIDSSH

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript për këtë media.